



Rr. "Abdi Toptani", ish Hotel Drini



info@kmshc.al



www.kmshc.al

17 Shkurt 2025

NJOFTIM

PËR PJESËMARRJEN E PËRFAQËSUESVE TË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL NË KONFERENCËN VJETORE NDËRKOMBËTARE TË IIAS 2025

Në datat 10-14 Shkurt 2025, përfaqësues të Komisionerit morën pjesë në Konferencën Vjetore Ndërkombëtare të organizuar nga Instituti Ndërkombëtar i Shkencave Administrative (IIAS), në bashkëpunim me Departamentin e Reformave Administrative dhe Ankesave Publike të Indisë (DARPG), e mbajtur në New Delhi, Indi.

Konferenca trajtoi temën kryesore: "Reformat Administrative të Gjeneratës së Ardhshme – Fuqizimi i Qytetarëve dhe Arritja e Shtresës së Fundit", duke mbledhur përfaqësues të institucioneve publike, ekspertë të administratës publike dhe akademikë nga vende të ndryshme të botës.

Ndër çështjet kyçe që u trajtuan gjatë kësaj konference ishin:

- ✓ Politikat për zhvillimin e burimeve njerëzore – Trajnimi dhe zhvillimi i nëpunësve civilë për një administratë më efektive dhe fleksibile.
- ✓ Transparenca dhe mekanizmat e llogaridhënies – Praktikrat më të mira në luftën kundër korrupsionit dhe forcimi i institucioneve të pavarura mbikëqyrëse.
- ✓ Harmonizimi i administratës publike me standardet evropiane – Eksperiencat e vendeve të rajonit në reformat administrative.

Pjesëmarrja në këtë konferencë përforcoi bashkëpunimin me institucione homologe dhe krijoi mundësi për shkëmbimin e praktikave më të mira në administratën publike.